



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLLEDHJES SË VEÇANTË TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
KOSOVËS, E MBAJTUR MË 15 SHKURT 2024, ora 10:00**

**SA POSEBNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 15. FEBRUARA 2024. GODINE, 10:00 časova**

**SHKURT - FEBRUAR
2024**

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i tri (3) Propozim-amendamenteve kushtetuese, me nr. 28, 29 dhe 30.

Dnevni red

1. Razmatranje tri (3) ustavna nacрта-amandmana, broj 28, 29 i 30.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,

Para se ta fillojmë këtë seancë të veçantë, sot është Dita e Komunitetit Ashkali. Në emër të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në emrin e deputetëve ua urojmë ashkalinjve të Kosovës këtë ditë të tyre, duke ua uruar të gjitha të mirat.

(Duartrokitje)

Të nderuar deputetë,

Kjo seancë është përparitur nga Kryesia e Kuvendit dhe e ka vetëm një pikë të rendit të ditës, e kjo është:

1. Shqyrtimi i tri (3) Propozim-amendamenteve kushtetuese, me nr. 28, 29 dhe 30.

Nënkryetari i Kuvendit, Kujtim Shala, dhe 39 deputetë të tjerë në kuadër të punës së procesit në Komisionin ad hoc për zhvillimin e procesit të vlerësimit kalimtar kanë propozuar tri amendamente kushtetuese. Gjykata Kushtetuese ndërkaq, më 25 janar të këtij viti e ka nxjerrë aktgjykimin e saj, në të cilin ka konstatuar se tri amendamentet e propozuara nga tri në dy prej tyre vetëm në formulimin “ka integritet të cenueshëm në kriteret kushtetuese për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ato i pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me kapitullin II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

Ndërsa, me të gjitha pjesët e tjera dhe formulimet e tjera ka konstatuar se këto nuk i pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me kapitullin II të Kushtetutës sonë.

Komisioni për Legjislacion në bazë të nenit 87 të Rregullores e ka parashtruar raportin me rekomandime në pajtim me këtë aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese dhe në dy amendamente propozohet që të fshihet fjala që e citova, ajo pjesa të cilën e citova, e cila thotë “ose që ka integritet të cenueshëm, për të qenë në harmoni kështu me aktgjykimin e gjykatës”.

Po ashtu, komisioni ka theksuar se edhe çështjen e numrave rendorë të amendamenteve ka rekomanduar që këto amendamente të riradhitën në numrat rendorë 28, 29 dhe 30, pasi që amendamenti 27 është në procedurë. Dhe, përfundimisht Komisioni Funkcional, pra i ka rekomanduar këto tri amendamente, neve na ka propozuar që t’i miratojmë ato.

Po ia jap fjalën fillimisht nënkryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Kujtim Shala, që ta paraqesë dhe t’i arsyetojë këto tri propozim-amendamente për Kushtetutën tonë. Urdhëroni, zoti nënkryetar!

KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë dhe,

Të nderuar anëtarë të qeverisë,

Fjala ime në të vërtetë është në emër të Komisionit ad hoc dhe është një tekst i dakorduar me anëtarët e komisionit. Një paraqitje do të thosha më shumë e natyrës teknike për këtë fazë të procesit.

Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën e mbajtur më 9 dhjetor 2022, pati formuar Komisionin ad hoc për zhvillimin e procesit të vlerësimit kalimtar për një mandat gjashtëmuor. Komisioni ad hoc për zhvillimin e procesit të vlerësimit kalimtar pas një pune intensive me të gjitha subjektet politike, me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë, në mbledhjen e mbajtur më 24 shkurt 2023 miratoi propozim-amendamentet kushtetuese dhe në pajtim me nenin 144, paragrafi 1 të Kushtetutës dhe nenin 87, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, kryetarit të Kuvendit i pati dërguar për procedim Gjykatës Kushtetuese.

Meqë puna e komisioni varej nga vlerësimi paraprak i Gjykatës Kushtetuese, komisioni në mbledhjen e mbajtur më 15 maj 2023 vendosi që të kërkojë zgjatjen e mandatit deri në përmbylljen e procesit të hartimit dhe të miratimit të amendamenteve kushtetuese, pastaj edhe të hartimit të projektligjit përkatës. Kuvendi me vendimin e datës 8 qershor 2023, sipas kërkesës, zgjati mandatin e këtij komisioni. Gjykata Kushtetuese së Republikës së Kosovës me aktgjykimin KO55/23 vlerësoi se amendamentet e propozuara nuk pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në kapitullin II: “Të drejtat dhe liritë themelore të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”, po ashtu gjykata në këtë aktvendim ka kërkuar që në amendamentet 27 dhe 28 të fshihen fjalët “ose që ka integritet të cenueshëm”.

Dhe, siç shihet nga raporti i Komisionit të Legjislacionit fjalët “ose që nuk ka integritet të cenueshëm”, pra ky formulim, sipas kërkesës së Gjykatës Kushtetuese, është fshirë.

Sot, kur jemi para procesit të votimit theksojmë se sipas nenit 144, paragrafi 2 të Kushtetutës, çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e 2/3 të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës, procedurë që do të ndjekim për të miratuar projekt-propozimet dhe për të hapur rrugë për të miratuar projektligjin përkatës. Vlerësojmë se gjithë puna dhe rezultati i komisionit varen drejtpërsëdrejti nga miratimi ose jo i këtyre projekt-amendamenteve.

Të nderuar kolegë, më lejoni që si kryetar i Komisionit ad hoc të falënderoj anëtarët e komisionit, të gjithë deputetët nënshkrues që kanë mbështetur projekt-amendamentet, partnerët vendorë dhe ata ndërkombëtarë që kanë ndihmuar punën e komisionit deri në këtë pikë të procesit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, nënkryetar Shala! Tash, po ia japim fjalën edhe kryetarit të Komisionit për Legjislacion, zotit Rrustemi, urdhëroni ta arsyetoni raportin e këtij komisioni.

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në pajtim me nenin 87, paragrafi 5, i Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 2. 2. 2024 shqyrtoi propozim-amendamentet kushtetuese të propozuara nga deputeti Kujtim Shala, i mbështetur nga 39 deputetë të tjerë dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë rekomandim.

Komisioni për Legjislacion ka shqyrtuar amendamentet kushtetuese të propozuara nga deputeti Kujtim Shala, i mbështetur nga 39 deputetë të tjerë, të vlerësuara me aktgjykim të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KO55/23. Komisioni për të vepruar në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese në amendamentet e propozuara 27 dhe 28, propozon që të fshihen fjalët “ose që ka integritet të cënueshëm” për të qenë në harmoni me aktgjykimin numër KO55/23.

Po ashtu, me qëllim të shmangies së paqartësive, komisioni ju rikujton që ndryshon renditja e propozim-amendamenteve pasi që, më 3. 8. 2023, Gjykata Kushtetuese i ka nxjerrë aktgjykimin nr. reference 2240/23 në rastin KO207/22 për amendamentin që bart numrin 27. Aktualisht ky amendament është në pritje për votim në Kuvend, sipas rekomandimit të Komisionit për Legjislacion të datës 19. 9. 2023.

Amendamentet marrin numrin sipas radhës pas miratimit të tyre në Kuvend, andaj komisioni në pajtim me aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe në pajtim me nenin 87, paragrafi 5, i Rregullores së Kuvendit rekomandon miratimin e amendamenteve, si në vijim, siç e keni në material. Faleminderit!

KRYETARI: Tash, është radha e grupeve parlamentare. Kush e jep qëndrimin e VV-së? Adnan Rrustemi!

ADNAN RRUSTEMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Më 4 shtator 2022 kryetari i Kuvendit zoti Glauk Konjufca zyrtarisht ka pranuar dosjen e dokumenteve të procesit të vetingut që është dorëzuar nga Kryeministri i Republikës, zoti Albin Kurti dhe ministrja e Drejtësisë, zonja Albulena Haxhiu.

Për të ndërtuar një konsensus të gjerë politik, Kuvendi me vendimin e datës 9 dhjetor 2022 kishte formuar Komisionin ad hoc për zhvillimin e procesit të vlerësimit kalimtar. Sa i përket punës së Komisionit ad hoc për zhvillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, u tha nga kryetari i komisionit, zoti Kujtim Shala, se ka pasur një konsensus politik, por edhe një bashkëpunim me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë. Ky komision ka bërë një punë të madhe dhe transparente, ku ka diskutuar gjatë me partnerët vendorë dhe ndërkombëtarë.

Edhe Ministria e Drejtësisë, por edhe Kuvendi udhërrëfyes kishin opinionin e Komisionit të Venecias, i cili ndër të tjera listoi një numër të madh problemesh në sistemin e drejtësisë, si: grumbullimi masiv i lëndëve të pazgjidhura, mungesa e besimit në sistemin e drejtësisë, ekzistimi i korrupsionit gjyqësor, stërzgjatja e gjykimeve, mungesa e efikasitetit të mekanizmave disiplinorë, nepotizmi në sistem dhe së fundi problemet me procesin e përzgjedhjes së kryeprokurorit e mungesa e cilësisë së vendimeve gjyqësore dhe probleme të tjera.

Të nderuar deputetë, shteti i Kosovës si Republikë demokratike e qytetarët e Kosovës meritojnë sistem të drejtësisë të pavarur, të paanshëm dhe efikas. Një sistem që trajton rastet në mënyrë të paanshme, të pandikuar, pavarësisht fuqisë, pozitës, pasurisë, a çfarëdo përkatësie tjetër të personit, por vetëm mbi bazën e ligjit dhe të fakteve. Ne kemi qenë dëshmitarë përgjatë viteve të një sistemi të ngathët, të ndikuar e të ndikueshëm, të anshëm e jo të pavarur, e mbi të gjitha joefikas. Rastet e tilla kanë bërë që besimi i qytetarëve në sistemin e drejtësisë të jetë tepër i ulët, kurse kredibiliteti i sistemit të drejtësisë të jetë i cenuar e i komprometuar.

Sot, nuk mendoj se diskutimi duhet shtruar mbi atë se a kemi nevojë për veting, apo jo. Vetingun e shohim të domosdoshëm dhe të pashmangshëm. Diskutimi duhet shtruar në atë se si duhej zhvilluar ky proces dhe sa më shpejt, në mënyrë që të vërtetojë gjyqtarë dhe prokurorë me integritet e profesional, e të largojë ata që vazhdojnë të jenë të ndikuar politikisht apo nga grupet e ndryshme të interesit, e të cilët kanë integritetin e kontestuar dhe profesionalizmin e munguar.

Ndër vite sistemi i drejtësisë është kritikuar, janë bërë ndryshime ligjore të vazhdueshme, por që asnjëra prej tyre nuk e ka ndryshuar gjendjen reale. Sistemi vuan nga gjyqtarë e prokurorë joprofesionistë dhe pa integritet, nga anëtarët e këshillave qoftë ai gjyqësor e prokurorial, e deri tek kryeprokurorët e kryetarët e gjykatave. Dikush mund të thotë që ky veting është jo i plotë, sepse prek vetëm kokat e sistemit, ata që kanë dilema po harrojnë që pikërisht këtu është problemi, tek krerët e sistemit, të cilët në fakt do të duhej të ishin pjesa më e ndritur e sistemit dhe jo njerëz që vetëm kanë ndërruar pozicionet e tyre dhe kanë përfituar nga pozicionet duke i shkaktuar dëm të madh sistemit të drejtësisë, veçmas atij gjyqësor dhe prokurorial.

Këtë që po e them e gjeni në raporte vendore dhe ndërkombëtare për faktin që grupet e krijuara brenda sistemit janë vendosur në krye të gjykatave dhe prokurorive, personat që nuk kanë pasur as performansë, e as kredibilitet të lartë profesional e moral, por që ishin njerëz të besueshëm. Në

bazë të modelit të vetingut që është zgjedh të bëhet, normalisht duke konsultuar në secilin hapë Komisionin e Venecias, në shikim të parë duket që prek disa persona, por që këta persona kanë përgjegjësi për gjendjen në sistem. Këtë proces të gjithë ata që janë meritore, kanë integritet, profesionalizëm, performansë dhe nuk kanë pasuri të pajustificueshme lehtësisht e kalojnë, kurse për të tjerët që s'i kanë këto cilësi, duhet të dalin nga sistemi. Pikërisht këtë e synojnë draft amendamentet e propozuara, të cilat dua të sqaroj pjesërisht përmbajtjen e tyre.

Amendamentet 28 dhe 29 do të instalohen si amendamente të përhershme, duke specifikuar dhe zgjedhur se çka është mosrespektim i rëndë i detyrave, nocion ky që është keqpërdorur dhe është interpretuar ngushtë, varësisht se kush ka qenë subjekt i hetimit dhe i vlerësimit.

Pra, këto amendamente kanë zgjeruar dhe specifikuar se çka nënkupton mosrespektimi i rëndë i detyrave si bazë për shkarkim, e që prefshin rastet kur prokurorja apo gjyqtari në mënyrë të vazhdueshme është vlerësuar me performansë të pamjaftueshme ose është vërtetuar se ka pasuri të pajustificueshme, ose ka bërë shkelje të rënda disiplinore sikurse që përcaktohet me ligj.

Kurse amendamenti 30 është i përkohshëm, kalimtar, pasi që ka përcaktuar mandatin e autoritetit të kontrollit të integritetit e që është dy vjet me mundësinë e zgjatjes edhe për një vit, nëse vendosen natyrisht me ligj të miratuar prej 2/3 të votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit.

Pra, ky amendament survejon autoritetin e kontrollit, ka këtë mandat 2+1 për të kontrolluar e verifikuar anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, anëtarët e Këshillit Prokurorial të Kosovës, kryetarët e gjykatave, si dhe kryeprokurorët, si dhe kandidatët për këto pozita, përjashtuar kryetarin e Gjykatës Kushtetuese. Ky amendament, ndonëse kalimtar, është shumë i fuqishëm, sepse në njërën anë do t'i kontrollojë subjektet, që theksova më lart dhe do t'i largojë ata pa cilësitë e lartcekura. Në anën tjetër, do t'i kontrollojë edhe kandidatët për këto pozitat, për afat aty hyjnë në sistem.

Të nderuar deputetë,

Ju keni parë rastet kur përkundër shkeljeve të rënda që kanë bërë gjyqtarët, apo prokurorët, ata janë amnistuar, ose kanë marrë dënim simbolik. Me këso dënimesh simbolike disiplinore, me këso vlerësimesh të performansës dhe me avancime të kundërligjshme e të ketë dilema për procesin e vetingut ose jo, është krejtësisht e pakuptueshme.

Tutje, nëse i referohemi indeksit të performansës së institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë prej vitit 2016 e këtej, në pyetjen se cilat nga institucionet në Kosovë influencohen nga ndikimi politik, e shihni se prin Prokuroria dhe gjykatat. Po ashtu, me dy amendamente të përhershme forcohet baza kushtetuese, se vlerësimi i vazhdueshëm në performansë të pamjaftueshme, ose është vërtetuar që ka pasuri të pajustificueshme, janë bazë e fortë që më pastaj, me ligje të veçanta, të ngritët standardi profesional dhe disiplinor në sistem.

Normalisht, krahas këtyre ndryshimeve kushtetuese, Ministria e Drejtësisë ka hartuar Projektligjin për kontrollin e integritetit të pozitive të caktuara në sistemin e drejtësisë, përmes të cilit do të gjejnë zbatim këto amendamente. Ashtu siç kemi pasur një punë transparente dhe gjithëpërfshirëse në Komisionin ad hoc në hartimin e amendamenteve kushtetuese, do të jemi edhe gjatë shqyrtimit të këtij projektligji.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Sot po përmbyllet një punë e madhe e Komisionit ad hoc dhe një zotim, natyrisht, për sistem të drejtësisë të pavarur dhe të paanshëm, si dhe efikas. E kuptoj që këto draft-amendamente kërkojnë një konsensus të gjerë politik të paraparë me Kushtetutë. Ndoshta, sot edhe nuk mund të votohen këto ndryshime, për shkak të rrethanave të njohura politike, por vetingu nuk ka alternativë dhe i shërben secilit qytetar, pa dallim politik e etnik. Faleminderit!

KRYETARI: Qëndrimi i Grupit Parlamentar të PDK-së.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Si Grup Parlamentar i Partisë Demokratike e kemi përkrahur në plotësi procesin e Vetikut dhe mendojmë që është një proces i pashmangshëm dhe duhet të ndodhë, pra në kuadër të gjyqësorit dhe të Prokurorisë së vendit tonë.

Si grup parlamentar, po ashtu kemi kërkuar që ky proces të bartet nga Kuvendi për hir të një konsensusi më të gjerë politik, për shkak se duhen edhe ndryshime kushtetuese. Fatmirësisht, kjo është një prej çështjeve, në të cilën kemi arritur konsensus së bashku edhe me partinë në pushtet, me Lëvizjen Vetëvendosje, gjithmonë për të qenë një proces sa më transparent, një proces që do ta fuqizonte sistemin gjyqësor dhe sistemin prokurorial në vendin tonë.

Në proces e sipër, së bashku me deputetët e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, që kanë qenë pjesë e këtij procesi, zonjën Blerta Deliu-Kodra dhe deputetin Rashit Qalaj, pa dyshim se i kemi pasur vërejtjet tona për disa çështje në kuadër të këtij draftimi që i është dërguar Gjykatës Kushtetuese. Mirëpo, ne asnjëherë nuk kemi dashur të prishim konsensusin dhe jemi pajtuar me komplet ekipin, grupin dhe kryetarin e komisionit, zotin Shala, që të procedojmë në atë formë sikurse kanë qenë.

Dhe unë, si deputet i Kuvendit të Kosovës, jam i vetmi që kam bërë komente në Gjykatën Kushtetuese, pra sa u përket këtyre amendamenteve. Te dispozitat e përhershme, siç e tha edhe parafolësi, ku flasim për nenet 27 dhe 28, kur flasim për integritetin e cënueshëm, kjo është një çështje mjaft komplekse. Me çka duhet të matet integriteti i cënueshëm? Qysh duhet të jetë kjo çështja e integritetit të cënueshëm? Dhe, me të drejtë, Gjykata Kushtetuese na ka dhënë të drejtë

në këtë proces dhe, tashmë kjo është larguar nga dokumenti zyrtar që e kemi në Kuvendin e Kosovës. Ndërsa, edhe sa i përket pasurisë së pajustificueshme, Gjykata Kushtetuese e qartëson shumë mirë, që bëhet fjalë atëherë kur prokurorë, apo gjyqtarë në fjalë, kanë pasuri të pajustificueshme dhe ajo vërtetohet me vendim të gjyqësorit, me vendim të formës së prerë.

Pra, këto janë të rëndësishme dhe ky proces, aq sa është i rëndësishëm, është po ashtu e rëndësishme që të mos pakësohen të drejtat e njeriut në kuadër të këtij procesi, të mos bëjmë dëm, sepse ne sot jemi, nesër do të ndërrohem, pa dyshim do të vijnë të tjerët. Mirëpo, procesi si proces ka për qëllim fuqizimin e strukturës së gjyqësorit në vendin tonë.

Pa dyshim, ashtu siç u tha edhe më herët, në shumë raporte, si në raportin për vendin edhe në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit, del se gjyqësori edhe kësaj dite vazhdon të jetë i cenueshëm dhe cenueshmëria është thjesht për shkak edhe të mospërkrahjes së duhur politike, që ndoshta ndër vite, edhe këto vitet e fundit, nuk ia kemi dhënë, sepse vazhdon të vuajë edhe nga mungesa e fondeve, vazhdon të vuajë edhe nga mungesa e numrit të duhur të prokurorëve dhe gjyqtarëve dhe fatkeqësisht, ende nuk e kemi mbërritur nivelin e duhur të gjyqtarëve për kokë banori, ashtu siç është në vendet evropiane.

Pra, të nderuar deputetë, fatkeqësisht në mungesë të Listës serbe në këtë rast, këto ndryshime kushtetuese me gjasë nuk do të mund t'i procedojmë më tutje, mirëpo asnjëherë si Kuvend nuk duhet të heqim dorë nga ky proces. Shpresoj që në një të ardhme sa më të afërt, shpresojmë në kuadër të kësaj legjislature, të arrijmë t'i procedojmë përpara dhe ky proces të fillojë dhe ta fuqizojë sistemin gjyqësor dhe prokurorial në vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Po, tash qëndrimi i Lidhjes Demokratike, kryetari Gashi.

ARBEN GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

Sa i përket këtij procesi të ndjeshëm politik dhe kushtetues, patjetër duhet të marrim në konsideratë disa elementë. Elementi i parë i dhënies së konsensusit opozitar dhe përfshirjes në këtë proces ka qenë elementi i edukimit politik. Pra, edukimi politik për pushtetin aktual ka qenë një domosdoshmëri, sepse në konceptin e tyre janë disa elemente, që janë të papranueshme dhe të cilat nuk mund të implementohen në ligje. Në vazhdimësi është parë një tendencë e kapjes së pushtetit, sidomos pushtetit gjyqësor dhe ndikimit të tij politik dhe kjo ka mbërritur, për hir të konsensusit, të përfshihet edhe deri në amendamente kushtetuese, për të cilat ne në vazhdimësi ishim të bindur që nuk do të kalojnë në Gjykatën Kushtetuese.

Koncepte të tilla, si koncepti i integritetit të cenueshëm, janë koncepte abstrakte, në vetvete edhe absurde, koncepte të cilat nuk mund të zbatohen dhe të cilat janë koncepte që lënë hapësirë të jashtëzakonshme për abuzim, abuzim i cilitdo pushtet që nesër do të merret me këtë proces.

Prandaj, ky edukim i vazhdueshëm politik ka qenë i domosdoshëm për pushtetin aktual dhe në të njëjtën kohë, edukimi i vazhdueshëm politik është bërë me veprimet e tjera që jemi detyruar si parti opozitare t'i ndërmarrim, si në Ligjin për Këshillin Prokurorial, si në Ligjin për Prokurorin e Shtetit, plus ligje të tjera, të cilat jemi detyruar që t'i dërgojmë në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykata Kushtetuese të japë vendimin e vet, se këto ligje në mënyrën se si janë trajtuar, pra me idetë prapa këtyre ligjeve, në përmbajtjen e tyre janë antikushtetuese.

Po le t'i kthehemi përmbajtjes dhe idesë fillestare dhe gjenerale. Ideja dhe propozimi ynë është që të kemi një sistem efikas të drejtësisë, që drejtësia të ndajë drejtësi dhe jo padrejtësi dhe kjo në të gjitha hallkat e saj. Dhe, ne kemi propozuar, duke pasur parasysh elementet që janë problematike dhe sidomos duke pasur parasysh se është shumë vështirë të bëhen ndryshime kushtetuese në Kosovë, për shkak të 2/3-ve të dyfishta, ne kemi qenë konsekuentë dhe kemi kërkuar në vazhdimësi që të jenë disa elemente. E para, të bëhet një sistem i monitorimit të performansës në sistemin prokurorial dhe sistemin gjyqësor.

Pra, të ndërtohet një sistem i monitorimit dhe verifikimit të vazhdueshëm. Supozojmë, Këshilli Prokurorial, me ligj ta obligojmë që të ndërtojë një sistem të verifikimit të rasteve. Prej momentit kur hapet një rast nga një prokuror, deri në momentin kur ai rast merr verdiktin final, të vlerësohet sa raste i ka hapur, sa raste i ka dërguar në gjykatë, sa prej këtyre rasteve i ka fituar në shkallën e parë, sa prej këtyre rasteve janë rrëzuar në shkallën e dytë, sa prej këtyre rasteve kanë shkuar në shkallën e tretë dhe është marrë një vendim tjetër dhe sa prej këtyre rasteve kanë shkuar në Gjykatën Kushtetuese?

Të njëjtat vlejné edhe për gjyqtarët: sa raste kur gjyqtarët kanë gjykuar në shkallën e parë e janë rrëzuar në shkallën e dytë? Sa raste të gjykuara në shkallën e dytë, janë rrëzuar në shkallën e tretë, apo në Kushtetuese? Dhe, duhet ta kemi parasysh edhe një element tjetër. Ne jemi në hapat e fundit të anëtarësimit të Kosovës në Këshillin e Evropës dhe me anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës Kosova, qytetarët e Kosovës, marrin të drejtën që t'i drejtohen edhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila është në Strasburg. Dhe, pastaj edhe kjo është një sistem tjetër i verifikimit.

Dhe, krejt këto të ndërtohen brenda sistemit të brendshëm, në Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor, të cilat do të mundësonin të kemi një drejtësi që ndan drejtësi, jo një drejtësi që ndan padrejtësi, me vonimin e rasteve, me humbjen e qëllimshme nëpër sistemin gjyqësor dhe me lënien e qëllimshme që rastet të parashkruhen.

Pra, duhet të ndërtohet një sistem efikas, duke marrë parasysh rrethanat aktuale, në të cilat gjendet vendi. Kjo për ne ka qenë prioritet i jashtëzakonshëm, ka qenë e pamundur të kemi një dialog politik dhe diskutim politik me pushtetin aktual, për të kuptuar cilat janë rrethanat reale aktuale, mbi të cilat ne duhet të bëjmë ndryshime. Nuk ka pasur vullnet dhe as njohuri për këto

koncepte dhe nuk ka pasur as qasje për ndryshime kualitative në sistemin e drejtësisë. Krejt ideja e tyre ka qenë ide përmbysëse - ide revolucionare, që do të duhej të implementoheshin në mënyrë arbitrare, për sa është e mundur me ligje, të cilat mund të kalohen me shumicën e thjeshtë nga shumica qeverisëse dhe pastaj, kur e panë që ato po shkojnë në Gjykatë Kushtetuese dhe po rrëzohen, ndërtuan një sistem akuzimi dhe anatemomi për opozitën - pse po i dërgon rastet në Gjykatë Kushtetuese?

Dhe, ideja tjetër, me një revolucion kushtetues të ndërtohen mekanizma të tipit “integritet i cenueshëm personal i gjyqtarit apo prokurorit”, që është një term i pashpjegueshëm, abstrakt dhe absurd më vetvete, i cili e cenon pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe prokurorial dhe i cili në tërësinë e tij do të jetë kundërproduktiv.

Prandaj, mendoj se anëtarët e komisionit kanë bërë një punë të mirë. I përgëzoj për punën që kanë bërë, por është ditur që në fillim se objektivi nuk do të arrihet. Objektivi nuk do të arrihet, sepse qëllimi është i gabuar dhe edukimi politik i mazhorancës aktuale është akoma i limituar. Kemi dhënë kontributin tonë, do të vazhdojmë të japim kontributin tonë, përderisa është e pamundur që edukimi të bëhet si proces nëpërmjet debatit kualitativ kuvendor, atëherë edukimi bëhet me forcë. Pra, forca në këtë rast është forca e institucioneve, institucionet ligjore që ndajnë drejtësi dhe në këtë rast, i vetmi institucion ligjor që ndan drejtësi është Gjykata Kushtetuese.

Ne jemi detyruar nga vendimmarrja e kësaj qeverisjeje që t’i drejtohem Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykata Kushtetuese në të gjitha rastet na ka dhënë të drejtë. Na ka dhënë të drejtë, sepse ideja e kapjes së shtetit nëpërmjet përdorimit të pushtetit është e gabuar, sidomos në sistemin e drejtësisë. Unë, në të njëjtën kohë, jam i vetëdijshëm se këtu duhet një balancim dhe kontroll i vazhdueshëm i sistemit të drejtësisë.

Pra, kemi folur për disa elemente, prej sistemit të verifikimit dhe monitorimit në sistem, të gjitha niveleve të vendimmarrjes, deri te sistemi i kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Jemi pajtuar që të ketë verifikim dhe kontroll të njehershëm për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët dhe jemi pajtuar që të vendoset mbi baza ligjore, sipas ligjeve të Kosovës, edhe kontrolli dhe verifikimi periodik i pasurisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Pra, të kontrollohen njëherë të gjithë dhe pastaj, në mënyra periodike, në periudha periodike, qofshin ato trevjeçare, katërvjeçare, të rikontrrollohet edhe një herë në mënyrë të detajuar pasuria e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Pra, ideja është që të ndërtohet një sistem i balancuar i vendimmarrjes së drejtësisë, e cila ndan drejtësi dhe jo padrejtësi dhe jo të ndërtohet një sistem mbi bazën e të cilit vullneti politik do të kthehet në vendim gjyqësor. Pra, kjo është e papranueshme.

Ideja që vullneti politik të kthehet në vendim gjyqësor, mbi paragjykimet politike, është i gabuar dhe ai sistem nuk do të ndodhë dhe nuk guxon të ndodhë në Kosovë. Prandaj, kontributi ynë si parti opozitare, përveçse ka qenë kontribut aktiv në debate, ka qenë kontribut aktiv në propozime e në komision, ka qenë kontribut aktiv e edukues për mazhorancën aktuale, duke iu drejtuar organeve kompetente, siç janë: Gjykata Kushtetuese, dhe në të ardhmen do të kemi raste, edhe organeve të tjera, mbinacionale, sapo Kosova të jetë pjesë e institucioneve, siç është Këshilli i Evropës.

Duhet ta kuptojmë dhe sidomos qeverisja aktuale duhet ta kuptojë kompleksitetin e organeve të drejtësisë dhe sistemit të drejtësisë. Ky është një kompleksitet vendimmarrës dhe nuk guxon të disbalancohet, sepse sot ju jeni në pushtet, nesër mund të vijë disa të tjerë. Sigurisht që do të vijë.

Pra, duke mos e paragjykuar vullnetin as tuajin që jeni sot në pushtet e as të atyre që do të jenë nesër në pushtet, ndërtojmë sistem i cili është efikas, i balancuar dhe i cili vetë kontrollohet në vazhdimësi. Kjo është ideja e ndërtimit të një sistemi efikas, jo të një sistemi të një ndërhyrjeje brutale nga institucionet ekzekutive mbi institucionet e drejtësisë. Në të njëjtën kohë, as të mos lejohet që të ndërtohen institucione të ashtuquajtura të drejtësisë që ndajnë padrejtësi duke pretenduar pavarësi absolute. Pra, pavarësia absolute është e rrezikshme, aq sa është e rrezikshme edhe ndërhyrja dhe kapja institucionale shtetërore, në këtë rast ekzekutive.

Pra, për ne është me rëndësi që të ndërtohet një sistem efikas dhe për të ndërtuar një sistem efikas duhet në vazhdimësi që kjo qeverisje dhe ky pushtet të edukohet. Edukimi ka qenë në mënyrën më të ashpër të mundshme, sepse debatin nuk e kuptojmë, argumentin nuk e pranojnë, atëherë vendimi i gjykatës është ai që i edukon përfundimisht. Faleminderit!

KRYETARI: Qëndrimin e AAK-së, kush e jep? Deputeti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ju të pranishëm,

Sa i përket punës së komisionit, mendoj që e kemi dhënë kontributin të gjithë në atë komision, duke përfshirë edhe Këshillin Gjyqësor, faktorin ndërkombëtar dhe organizatat e tjera. Kemi pasur diskutime të mjaftueshme, kemi pasur edhe mospajtime, por në fund kemi ardhur deri te pajtimi dhe deri te përkrahja e ndryshimit, apo vijmë deri te vetingu.

Ajo që vlen të theksohet, më vjen keq që mund të them që sapo dëgjuam kryetarin e komisionit që tha që sistemi ka qenë i papranueshëm gjyqësor, është dashur të ndërhyhet. Ne e kuptojmë që me të vërtetë që duhet të ndërhyhet, por për njëzet vjet ky sistem gjyqësor është ndërtuar nga shumë profesionistë, nga ata që janë munduar që të kemi pushtete të ndara dhe që të hedhet ad

hoc poshtë e gjithë ai mund dhe ai krijim i këtij sistemi, mendoj që është e papranueshme dhe lë mjaft për të dëshiruar. Mazhoranca mendon që gjithçka çka është e mirë rrjedh nga koha kur kanë filluar të qeverisin këta. Ne e kemi parë që kemi dobësi në sistem. E kemi parë që ka prokurorë dhe gjyqtarë jo me integritet, por që marrin vendime që ndoshta nuk janë të pranueshme. Mirëpo, ju e dini që shteti i Kosovës nuk ka aq përvojë të madhe si kanë shtetet në rajon. Për çdo vit, për çdo ditë duhet të reformohet edhe sistemi i drejtësisë, por mbi të gjitha duhet që të kemi pushtete të ndara dhe politika duhet të jetë larg gjyqësorit.

Prandaj, ne si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës, i kemi përkrahur këto amendamente, edhe pse Gjykata Kushtetuese e ka dhënë vlerësimin. Për hir të një konsensusi, ne do t'i përkrahim, por që ju e dini që duhen edhe dy të tretat e minoriteteve. Faleminderit!

KRYETARI: Enis Kervan, në emër të Grupit Multi-etnik.

ENIS KERVAN: Faleminderit, kryetar!

E nderuar ministre,

Të nderuar kolegë deputetë,

Së pari, dëshirojmë të përgëzojmë anëtarët e komisionit për punën dhe bashkëpunimin. Ne si Grup Parlamentar Multi-etnik me përfaqësues të komuniteteve: turk, boshnjak, rom, ashkali dhe egjiptian, e mbështesim procesin e vetingut. E konsiderojmë si të domosdoshëm për ngritje të performansës dhe profesionalizmit të të gjitha hallkave të sistemit të drejtësisë në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht, plotësim-ndryshimet e propozuara kushtetuese nga komisioni ad hoc i Kuvendit të Kosovës i konsiderojmë të domosdoshme dhe e mbështesim.

Fatkeqësisht, si përfaqësues të komuniteteve joshumicë, prapë dhe për të satën herë, kemi pasur rastin edhe me ligjet e tjera, të bartim pasojat nga mospjesëmarrja e kolegëve deputetë të komunitetit serb. Shpresojmë që sa më parë të kemi një normalitet të plotë në Kuvend dhe të jemi në gjendje të votojmë edhe plotësim-ndryshimet kushtetuese, të cilat për një kohë e tashmë janë pamundësuar.

Mendojmë që komunitetet joshumicë, të cilat i kemi të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe ligje nuk duhet t'i keqpërdorim për çështje politike apo personale. Në fund të fundit, këto ndryshime kushtetuese janë ndryshime që shërbejnë për të gjithë sistemin e drejtësisë më të mirë për të gjithë qytetarët në Republikën e Kosovës pa dallim. Faleminderit!

KRYETARI: Z. Rustemi, a keni ndonjë replikë, apo jo? Driton Selmanaj është lajmëruar dhe pastaj po e qesim në votim. edhe Qeverisë ia japim fjalën, pse jo. Ka çka të thuhet.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Procesi i vetingut ose të them reforma në sistemin e drejtësisë tash ka kohë që është bërë jo veç narrativë e përbashkët kështu e të gjitha partive politike, por mendoj që edhe me të drejtë janë ngritur shumë çështje për shqetësimet që ne kemi pasur për sistemin e drejtësisë në Kosovë.

Unë t'ju them të drejtën, kam dilemat e mia nëse jemi duke e adresuar atë çfarë në fakt kemi folur tash e shumë vite në Kosovë. A jemi duke i adresuar çështjet me të cilat vërtet përmirësohet sistemi i drejtësisë në Kosovë? Fatkeqësisht, unë mendoj se jo. Pse po ndodh kjo? Sepse, kam bindjen që ky proces ka nisur mbrapshtë, të nderuar kolegë deputetë.

Çfarë ka bërë Ministria e Drejtësisë? Ka dërguar një koncept-dokument në Komisionin e Venedikut me pesë opsione të vetingut në Kosovë. Gati, rast i paprecedent, sepse Qeveria zakonisht duhet të dërgojë një opion, mendimin e vet politik për mënyrën se si e shoh përmirësimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë, por kjo e ka dërguar me pesë opsione.

Dhe, për çudi, rekomandimet që kanë dalë nga Komisioni i Venedikut me këto amendamente sot, asnjëri prej opsioneve të ministres nuk janë reflektuar këtu. As opsioni i parë, as opsioni i dytë, as opsioni i tretë, as opsioni i katërt, as opsioni pesë. Që i bie, sipas asaj që ne sot po votojmë këtu, asnjëra nga çështjet që kjo Qeveri i ka konsideruar si politika publike të rëndësishme për sistemin e drejtësisë, nuk janë reflektuar në amendamente.

Normalisht, që i është kufizuar shumë puna komisionit, në bazë të rekomandimeve të Komisionit të Venedikut dhe më pas edhe me Gjykatën Kushtetuese, komisioni ka ardhur në situatë ku gati s'ka pasur çka të bëjë dhe na ka sjellë amendamente kushtetuese të panevojshme. Pse e them të panevojshme? Se të gjitha çështjet që po mendohet tash, kinse do të adresohen me amendamentet kushtetuese, në fakt ato adresohen me ligjet. Ne mund t'i përmirësojmë ato me ligjet e aplikueshme sot që janë në Kosovë.

Ne, ose them komisioni i partive politike, ka propozuar që të shkarkimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtohet edhe një element. Cili është ai? Për t'i shkarkuar ata, duhet të matet edhe integriteti, a është integriteti i cënueshëm apo jo. Po Gjykata Kushtetuese, pikërisht për atë na ka thënë: s'mund ta bëni këtë. Sepse na ka thënë: kjo pakëson liritë dhe të drejtat e njeriut, të përcaktuara me Kapitullin II.

Çka miratojmë sot? Them, ky autoritet i cili do të kontrollojë integritetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, kriteret do të përcaktohen me ligjet. Po Gjykata Kushtetuese po thotë jo, se integritetin s'mund ta matësh, sepse siç e tha z. Gashi, është nocion abstrakt. Tash ne po themi këtu, po votojmë diçka, por Gjykata Kushtetuese na ka thënë, cenimin e integritetit nuk guxon ta prekni, por ne po themi e rregullojmë me ligj sesi e matim integritetin e gjyqtarëve dhe

prokurorëve. Kur po ndalemi këtu, do ta bëjmë një veting, por vetëm për organet udhëheqëse, Këshillin Prokurorial, Këshillin Gjyqësor, kryetarët e gjykatave, kryetarët e prokurorive dhe po them stafin menaxherial që i bie vetëm udhëheqësit. A është problemi në Kosovë, të nderuar kolegë deputetë, te sistemi i drejtësisë, stafi udhëheqës? Unë kam bindjen që jo. Cila është bindja ime? Bindja ime është që problemi themelor i sistemit të drejtësisë në Kosovë është inkompetenca e tyre, mungesa e profesionalizmit të tyre. A jemi duke e adresuar këtë me këto amendamente kushtetuese? Jo, të nderuar kolegë deputetë, jo.

Performansë është me ligje, edhe me Ligjin për KPK-në, edhe me Ligjin për Prokurorinë e Shtetit, edhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, edhe me Ligjin për Gjykatat në Kosovë, performansa, matja e performansës dhe mekanizmat e matjes së performansës janë brenda institucioneve aktuale që i kemi. Prandaj, sot ne jemi të vetëdijshëm që s'mund të kalojnë këto, për shkak që nuk i kemi votat që nevojiten, për shkak të kompleksitetit të vendimmarrjes për ndryshimet kushtetuese që e kemi. Po ju them që ky veting nuk është. As mos e përdorni askund. Ky nuk është veting. Kjo është përpjekje për të rehabilituar narrativet politike populliste të të gjithëve, jo vetëm të një partie politike para opinionit publik.

Kjo që duam t'i japim votë sot, nuk e adreson shqetësimin themelor që e kemi ne për sistemin e drejtësisë. Këtë që po e bëjmë sot, ose që do ta bëjmë nesër, nuk i jep zgjidhje efikasitetit ose përmirësimit të sistemit të drejtësisë në Kosovë. Improvizojmë politikisht, improvizojmë strukturalisht, zgjidhje nuk japim. Mos të harrojmë që sot kur ne po flasim, mbi 150 prokurorë dhe gjyqtarë të rinj janë futur në sistem pasi ka ardhur Lëvizja Vetëvendosje në pushtet, plus 150 prokurorë, afër treqind. A kemi vendosur ne sistem filtrimi të procesit të rekrutimit në Kosovë? Jo! Këtu është problemi themelor, po këtë s'po e adresojmë këtu.

Besomëni, problemin themelor sot e kemi edhe në gjyqtarë e prokurorë, për shkak që janë aktualisht, por për shkak të inkompetencës së tyre për të ushtruar profesionin, po s'jemi duke folur hiç kush po na hyn në sistem, a janë të aftë këta të rinj e të reja që po hyjnë në sistem. Jam i bindur që një pjesë e tyre, besomëni që nuk e kanë vendin në sistemin e drejtësisë. Gabimet që po i bëjnë në dokumentet fillestare të një procedure gjyqësore ose prokuroriale janë të tmerrshme, gjuhësisht janë të tmerrshme, mos të them që profesionalisht edhe më të tmerrshme.

Ku jemi nisur ne? Ta rehabilitojmë veten si politikë, sepse e kemi mbyllur shumë këtë çështje, jemi ballafaquar shumë me njëri-tjetrin, e duhet thënë popullit: po bëjmë diçka.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po më vjen keq, s'jemi duke bërë asgjë. Unë po them do ta jap votën për shkak të punës që e ka bërë ky komision konsensual e i cili po them puna ka qenë derivat i kushtëzimeve që ia ka bërë Komisioni i Venedikut dhe Gjykata Kushtetuese. S'kanë pasur mundësi këta të bëjnë diçka tjetër, ose ishte dashur ta anulojnë, të thonë s'po bëjmë këtu asgjë. Çështjet që po adresohen këtu,

nuk janë çështje kushtetuese, janë çështje ligjore. Ne po improvizojmë amendamente kushtetuese, që dikur jam i bindur do të jenë rast studimi për juristët e mirë. Do të qeshin me amendamentet tona që ne sot po i trajtojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Ia japim fjalën edhe Qeverisë. Ministres Haxhiu, pas deputetëve. Le ta japë edhe mendimin e vet Qeveria, pastaj vazhdojmë me deputetët e tjerë.

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

I nderuar ministër Çeku,

Të dashur qytetarë të Republikës dhe media që po e përcjellin këtë seancë,

Pas një angazhimi të madh, sot po e trajtojmë amendamentet kushtetuese për vetingun në sistemin e drejtësisë, një ndër reformat më të rëndësishme që ka për qëllim fuqizimin e institucioneve të drejtësisë, kthimin e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë dhe më e rëndësishmja pavarësinë e sistemit të drejtësisë.

Siç jeni në dijeni, vetingu në sistemin e drejtësisë ka qenë një nga zotimet tona kryesore para qytetarëve të Republikës së Kosovës. Për të ardhur deri këtu, nuk ka qenë aspak e lehtë, sepse gjatë gjithë kësaj kohe jemi ballafaquar me sfida nga më të ndryshmet. Sfida këto sidomos që ndërlidhen me tendencën e vazhdueshme për të penguar një reformë të rëndësishme, por siç e dini, po ashtu kemi qenë këmbëngulës në synimet tona për ta bërë Kosovën shtet të së drejtës dhe për të përmbushur secilin zotim që kemi dhënë para qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Më lejoni vetëm shkurtimisht e kronologjikisht të përmend disa veprime që ndërlidhen me këtë reformë. Në mars të vitit 2021 kam pranuar detyrën e ministres së Drejtësisë, dhe menjëherë në prill të po atij viti kam themeluar grupin punues për hartimin e koncept-dokumentit për vetingun në sistemin e drejtësisë.

Në tetor të vitit 2021 Qeveria votoi koncept-dokumentin për vetingun në sistemin e drejtësisë, por po ashtu në tetor pas votimit të koncept-dokumentit formuam grupin punues për hartimin e amendamenteve kushtetuese për vetingun në sistemin e drejtësisë sipas opsionit 5 të koncept-dokument. Pra, i cili adresonte nevojën e vetingut përmes ndryshimeve kushtetuese.

Në tetor, po ashtu koncept-dokumentin dhe amendamentet kushtetuese për vetingun në sistemin e drejtësisë i dërguam për opinion në Gjykatën Kushtetuese.

Është e vërtetë që edhe koncept-dokumentin edhe amendamentet kushtetuese i kemi dërguar në Gjykatën Kushtetuese, në fakt, në Komisionin e Venecias, sepse qëllimi ka qenë që ta njoftojmë Komisionin e Venecias për problemet me të cilat ballafaqohet sistemi i drejtësisë, sfidat të cilat ne i kemi, dhe po ashtu e kemi njoftuar Komisionin e Venecias se cili është opsioni që Qeveria e

Republikës së Kosovës e mbështet. Pra, ka qenë opsioni 5 që ka kërkuar që të ketë amendamente kushtetuese për vettingun në sistemin e drejtësisë.

Po ashtu kemi zgjedhur të konsultohemi me Komisionin e Venecias, duke e pasur parasysh rëndësinë e kësaj reforme, por po ashtu edhe aspektin e thellë të kësaj reforme, pra, sa e thellë kjo reformë është, dhe nuk kemi mundur që ta anashkalojmë një Komision të Venecias siç është mekanizmi më i rëndësishëm i Këshillit të Evropës.

Në qershor të vitit 2022, pra, pas 8 muajsh, ne pranuar opinionin e Komisionit të Venecias në raport me amendamentet kushtetuese me ç'rast Komisioni i Venecias theksoi rëndësinë e reformës në drejtësi dhe rekomandoi që vetingu në sistemin e drejtësisë të nis nga nivelet e larta të sistemit të drejtësisë, që përfshihen Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, kryeprokurorët e të gjitha prokurorive, kryetarët e gjykatave, dhe atë përmes mekanizmit të jashtëm kushtetues që njihet si autoriteti kalimtar i vlerësimit të integritetit.

Së bashku me kryeministrin Kurti, në fund të qershorit të vitit 2022 kemi takuar subjektet opozitare me qëllim të arritjes së konsensusit për një nga reformat më rëndësishëm në vend. Kërkesa e opozitës ka qenë që dosja e vetingut të bartet në Kuvend, kështu që më 4 shtator të vitit 2022, dosjen e vetingut, së bashku me kryeministrin Kurti, e kemi dërguar te kryetari i Kuvendit, sepse për neve ka qenë shumë i rëndësishëm konsensusi për një nga reformat më të rëndësishme në drejtësi.

Më lejoni që të falënderoj kryetarin e komisionit ad hoc, zotin Kujtim Shala, po ashtu të gjithë anëtarët e komisionit ad hoc për bashkëpunimin, angazhimin dhe mbështetjen në procedimin e amendamenteve kushtetuese.

Në mars të vitit 2023, pas shqyrtimit dhe votimit të amendamenteve në komisionin ad hoc, kryetari i Kuvendit i procedoi, siç e dini, ato në Gjykatën Kushtetuese, dhe Gjykata Kushtetuese pas nëntë muajve i dha dritën e gjelbër vetingut në sistemin e drejtësisë.

Sa i përket çështjes së integritetit, më lejoni vetëm t'ju njoftoj se si e shohim ne atë. Si e shohin ekspertët që kanë punuar në këtë çështje edhe në kuadër të ministrisë, por edhe ata që kanë qenë të jashtëm. Kriteri integritet i cënueshëm nuk ka kaluar për arsye se gjykata e konsideron të paqartë dhe të paparashikueshëm, si dhe çështjet e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, tani thotë, janë të përfshira në baza të tjera kushtetuese dhe ligjore për shkarkim.

Në plan të parë konsideroj që është pozitive, se po nënkupton që integriteti apo mungesa e tij, cënueshmëria mund të definohet me ligj, dhe ka hapësirë që të krijohet një procedurë për kontroll të integritetit, qoftë nga mekanizmi i jashtëm që është validuar apo mekanizma të tjerë të

brendshëm në të ardhmen, pra te Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial, për të gjithë gjyqtarët dhe po ashtu për të gjithë prokurorët.

Për ne është shumë e rëndësishme që në aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese validohet kontrolli i integritetit si koncept që duhet të ekzistojë në Kosovë. Na jepet drita e gjelbër vlerësimi i integritetit të bëhet përkohësisht nga një mekanizëm i jashtëm, pra, jashtë Këshillit Gjyqësor dhe jashtë Këshillit Prokurorial për nivelet e larta të sistemit të drejtësisë.

Po ashtu është po aq e rëndësishme që pasuria e pajustificueshme është pranuar si rrethanë për largimin e një prokurori a gjyqtari nga sistemi, pra, në rrethanat kur ai apo ajo nuk mund ta justifikojnë pasurinë e tij apo saj.

Më lejoni po ashtu t'ju njoftoj para se të përmbyll fjalën time, që vetingu, amendamentet kushtetuese që sot po i trajtojmë nuk janë e vetmja reformë në të cilën po punën Ministria e Drejtësisë. Reforma tjetër është ajo në Këshillin Prokurorial, që është reformë po aq e rëndësishme do të thosha. Që Projektligjin për Këshillin Prokurorial e kemi në seancë dhe do ta trajtojmë dhe do të flasim enkas për atë reformë që e konsideroj jashtëzakonisht të rëndësishme dhe me peshë për ta bërë reformën në Këshillin Prokurial.

Por, po ashtu jemi duke punuar në zbatimin e deklaratës së zotimeve. Për momentin grupi punues që po e adreson deklaratën e zotimeve është në punëtori tri ditore. Dhe, në qershor të këtij viti, Qeveria pret që t'i procedojë të gjitha ndryshimet që ndërliken me pjesën e dytë të reformës që ka të bëjë me fuqizimin e mekanizmave të brendshëm të integritetit, disiplinës dhe të tjera.

Prandaj, unë besoj që edhe ai do të jetë një proces i rëndësishëm dhe uroj që njësoj edhe aty ta kemi mbështetjen dhe të jemi të unifikuar. Pra, reforma po bëhet në disa nivele dhe konsideroj që në këtë drejtim jemi në rrugë të mbarë.

Të nderuar deputetë,

Unë sot nuk do të flas për problemet me sistemin e drejtësisë, sepse ato i dimë, ato i kemi folur disa herë. Ato i gjejmë në raporte vendore dhe ndërkombëtare, por në fakt edhe i ndiejmë në përditshmërinë tonë. I ndiejnë edhe qytetarët e Republikës së Kosovës në përditshmërinë e tyre.

Por, sot e ritheksoj edhe njëherë që vetingu në sistemin e drejtësisë është çelësi që Kosova të jetë shtet i së drejtës. Vetingu është kushti që sistemi i drejtësisë, apo në sistemin e drejtësisë të kemi prokurorë me integritet të lartë moral, por edhe profesional.

Vetingu është rruga përmes së cilës mund të sigurohemi që gjykata dhe prokuroritë veprojnë vetëm në përputhje me mandatin e tyre kushtetues dhe me mandatin e tyre ligjor dhe të

pandikuar nga askush, nga asnjë individ kushdo qoftë ai, grupet e interesit po ashtu, apo pushtetet që vijnë e shkojnë.

Vetingu është mundësia për ta kthyer besimin e qytetarëve në institucionet e drejtësisë dhe për ta zhvilluar vendin si brenda, po ashtu edhe jashtë.

Prandaj, ju ftoj që të jemi të unifikuar për këtë reformë dhe të kontribuoni që këto amendamente kushtetuese të kalojnë. Kjo është në fakt ajo që çka qytetarët presin nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në fund, më lejoni vetëm t'i falënderoj të gjithë anëtarët e grupit punues, qoftë që kanë punuar në Ministrinë e Drejtësisë apo edhe anëtarët e komisionit ad hoc, sikurse edhe partnerët që na kanë mbështetur në këtë proces, sepse bashkëpunimi me ta ka qenë jashtëzakonisht i rëndësishëm për të ardhur sot në këtë seancë dhe për të diskutuar për këto amendamente që janë të rëndësishme, në fakt, janë jetike për vendin. Faleminderit!

KRYETARI: Ky ishte mendimi i Qeverisë. Tash deputetja Doarsa Kica-Xhelili e ka fjalën.

DOARSA KICA-XHELILI: Faleminderit, kryetar!

Unë po filloj me atë që ka disa ditë që po e diskutoj çështjen e vetingut, dhe nga aktorë të ndryshëm pyetem në raport se a do ta votoni vetingun ose jo.

Dhe, përgjigjen që unë e jap është që amendamentet kushtetuese që vijnë në Kuvend do t'i votojmë, por ky proces nuk është më proces i vetingut. Dhe, nuk kam se si të mos pajtohem me deputetin Selmanaj, që ne kemi të bëjmë me rehabilitimin e një procesi të vetingut që tashmë është proces i dështuar.

Pse po them që është proces i dështuar? Ne asnjëherë nuk e kemi pasur problemin e drejtësisë vetëm te krerët. Pak më herët u tha që krerë janë ajo ajka e cila më pas e shtron mënyrën se si funksionin sistemi i drejtësisë. Kjo lidhje me të vërtetën nuk ka.

Anëtarët e këshillave as nuk guxojnë, në fakt, të intereferojnë me mënyrën se si gjyqtarët marrin vendime e veprime. Njëlloj vlen për rastin e prokurorëve. Ata e kanë vetëm një analizë organizative të komplet sistemit të drejtësisë, deri diku sanksionuese dhe këto të fundit sërish mbesin ato me të cilat kjo shoqëri ka qenë shumë e pa kënaqur. Pra, me mungesën e reaksionit të këshillave në raste të caktuara.

Fatkeqësisht e fatmirësisht në të njëjtën kohë ka ndodh një ndryshim i krejt paradigmës së vetingut dhe mendoj që t'i bëjë nder shoqërisë. Në emër të vetingut është folur tepër shumë.

Drejtësia mbetet një ndër nocionet më të keqpërdorura e më së dëmshmi të shfrytëzuara në diskursin publik politik në Kosovë.

Diskutimi që trajtojmë sot njëkohësisht është një ndër diskutimet më të etabluara në politikën populliste kosovare. Dhe, ju mund ta vëreni që edhe në diskutimet e aktorëve të pushtetit sot, toni ishte më i zbutur. Më i zbutur se në njërën anë, të gjitha partitë politike morën pjesë në procesin e vetingut, por në anën tjetër, të themi, shqip e shkurt, ishte shuplakë nga vetë Gjykata Kushtetuese dhe sistemi i drejtësisë që gjërat nuk bëhen gjithmonë sikurse ne duam, sepse ky vend duke qenë demokratik ka edhe ndarje të pushteteve.

Dhe, diçka që ne me lehtësinë më të madhe mund ta themi në diskursin tonë popullist nuk mund ta zbatojmë në praktikë.

Fatkeqësisht në këtë diskurs që e përmenda është hedhur valle, pikërisht valle. Pse po e them valle? Sepse një person politikisht i matur dhe juridikisht i përgatitur, do ta kuptonte ndjeshmërinë e kësaj teme mjaftueshëm që në fillimin e saj që ta dijë si ta trajtojë asisoj që ky proces të mos dështojë akoma pa ardhur mirë në Kuvend.

Si rezultat i kësaj maturie politike e pjekurie juridike, ne do ta prioritetizojmë vetingun që në fillim e saj. Do të ishim të gatshëm të bënim kompromise me reforma të tjera potenciale për shkak të vetingut dhe të insistonim të aktorët ndërkombëtarë që kjo do të ishte forma e vetme që ne këtë proces mund ta shtyjmë përpara.

Sërish, arsyeja pse po e them edhe këtë ka të bëjë me faktin që Komisioni i Venecias e amputoi vetingun, e amputoi vetingun. Por, pse e amputoi vetingun në Kosovë, por vetingu nuk u amputua për Shqipëri? Pse, madje edhe çështja e Byrosë u amputua për Kosovë, por e njëjta nuk vlejti për Italinë.

Pra, thënë shkurt, interpretimet ligjore, dhe këtë duhet ta kuptoni mirë, kanë të bëjnë me aspektin subjektiv të një shoqërie. Kanë të bëjnë me atë që judikatura e kupton si proporcionalitet. Pra, subjektivja ka peshë. Ka rëndësi shoqëria. Ka rëndësi sistemi edhe kushtetues aktual në momentin që ne synojmë t'i bëjmë disa reforma.

Pra, thënë shkurt, duke mos pasur mundësinë të evitohet konteksti shoqëror, në rastin konkret, neve nuk na është dhënë besimi si politikë kosovare ta shtyjmë këtë proces deri në fund. Nuk na është dhënë besimi për diçka që u është dhënë të tjerëve. Pra, ka të bëjë specifikisht me ne si shoqëri e si politikë.

E pse nuk na është dhënë besimi? Nuk na është për atë që e thashë më herët, sepse ka pasur papjekuri politike në qasjen që e kemi pasur. Në momentin kur ti u shkon institucioneve

kredibile ndërkombëtare me gjuhë polarizuese të skajshme, duke folur me gjuhën sikurse flasin pushtetarët e sotëm për Gjykatën Kushtetuese dhe për aktorë të sistemit të drejtësisë, ti ndoshta edhe mund të fitosh në elektoratin tënd, por s'mund ta fitosh betejën e reformës në drejtësi.

Dhe, tani mendojeni ju se cila ka më shumë rëndësi nga këto të dyja: të fitohet beteja elektorale, kur flasim për vetingun, apo ta bëjmë vetingun realisht? Pra, mbetet fatkeqësi që procesi për të cilin po flasin sot, ka mbetur krejtësisht simbolik, simbolik sepse do t'i vetojmë vetëm krerët.

Akoma më simbolik është ky proces kur dëgjuam se si po flasin edhe për ristrukturimin e Këshillit Prokurorial të Kosovës. Atëherë, shtrohet një pyetje: nëse ju besoni fuqishëm që vetingu do të bëhet dhe vetingu do të jetë zgjidhja, atëherë pse po e ristrukturoni Këshillin Prokurorial? Sepse, pikërisht ata aktorë, pikërisht ata aktorë të Këshillit Prokurorial do t'i nënshtrohen vetingut. Pra, që në start, a po i bie që nuk po besoni procesit të vetingut.

Ndërkaq, ideja e ecjes paralele është ajo që na ka kushtuar te Komisioni i Venecias. Dhe, ju mund të thoni si të doni e çka të doni, por ne të gjithë jemi takuar me ata dhe ata komunikojnë me njëri-tjetrin, dhe duke qenë profesionistë e kanë pasur elementin e proporcionalitetit kur e kanë bërë analizën e pikërisht të të gjitha reformave që kanë shkuar para atij institucioni. Tani të kthehemi tek amendamentet kushtetuese. Po, është e qartë që LDK ka marrë drejtimin e këtij komisioni me bindjen që ajo pak çka ka mbetur, copëza të reduktuara e të amputuara duhet të shkojnë deri në fund. Duhet të shkojnë deri në fund së pari, sepse po mundohemi me aq sa ka mbetur ta bëjmë më të mirën, por gjithashtu duhet të shkojmë deri në fund, sepse kjo më nuk guxon të keqpërdoret, sepse diskursi publik politik më nuk guxon ta përmend vetingun si ndarësi shoqërore, si përçarje shoqërore.

E, kur flasim për drejtësinë, duhet të bëhet pyetja si konceptohet drejtësia prej atyre që e bëjnë, sepse drejtësi është kur për hir të zhvillimeve në sistem të drejtësisë i redukton sulmet ndaj gjyqësorit. Kur për hir të drejtësisë e reformave, nuk e shan në çdo të dytën fjalë Gjykatën Kushtetuese, kur për hir të drejtësisë, nuk i detyron drejtorët e policisë të suspendohen kur janë në gjendje të urdhërojnë hetime për aktorët e pushtetit. Drejtësi është kur partia në pushtet nuk bllokton emra të përveçëm, sepse nuk i pëlqejnë për të qenë kryeprokurorë, jo sepse ne s'mund të kemi opinion, por sepse pushtetet janë të ndara, sepse nuk na takon, sepse ndërhyjmë në demokraci. Përndryshe, nuk mund të vijojmë të thirremi në emër të drejtësisë e të gjitha veprimet që i ndërmarrin të jenë pikërisht kundër demokracisë në Kosovë.

Këtë nuk mund ta bëjmë më, sepse sikurse që po e shihni, po na kushton, po na kushton te aktorët ndërkombëtarë që në fund do të vendosin edhe për çështje tona të brendshme, sepse derisa ne themi që ata s'kanë rëndësi, ju e dini shumë qartë se opinionet e Komisionit të Venecias askush këtu nuk ka thënë se janë të parëndësishme dhe të mos e zbatojmë, përkundrazi. Të vetëdijshëm që mbështetja e amendamenteve kushtetuese kërkon 2/3 e votave që sot nuk po

më duket që i kemi, megjithatë ne mbesim pranë asaj që kemi thënë që vota jonë për këto amendamente kushtetuese mbetet për, mirëpo gjithmonë me shpresën që diskursi publik do të ndryshojë dhe në mënyrë ekskluzive dhe decitive të bëhet ajo që e tha shefi i grupit tonë parlamentar, zoti Gashi. Edukimi politik shkon krah më krah nganjëherë edhe me pamundësinë tënde që të bësh çfarë të duash kur je në pushtet dhe kjo është e mira e kësaj iniciative që ka ndodhur një shkapërderdhje e diskursit në të cilën keni llogaritur aq shumë, tani që e dini saktësisht se pushtetet janë të ndara dhe ju nuk mund të bëni absolutisht çfarëdo që doni në këtë vend. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë, zonja Haxhiu!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Faleminderit!

Disa çështje që ndërlidhen me fjalën e zonjës Doarsa Kica-Xhelili, edhe një herë po ju njoftoj që reformën në drejtësi po e bëjmë në disa drejtime dhe atë paralelisht, por natyrisht që nuk mund të them që deklarata e zotimeve është më e rëndësishme se procesi i vetingut, sepse edhe këtu ka renditje të gjërave: vetingu, reforma në Këshillin Prokurorial dhe deklarata e përbashkët e zotimeve, që aty jemi përveç Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, Gjykata Supreme po ashtu dhe Zyra e Kryeprokurorit të shtetit, por po ashtu po punojmë edhe me partnerët ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile.

Zonja Doarsa-Kica tha që procesi i vetingut është proces i dështuar, unë veç uroj që të mos jetë dëshirë e jotja kjo, por uroj shumë që të mos jetë dëshirë e jotja, por si shqetësim që mund ta ngresh si deputete e Kuvendit, nëse është kështu atëherë po të përgjigjem në disa çështje. Në fillim, ne kemi pasur propozimin që vetingu për sistemin e drejtësisë të bëhet me mekanizimin e jashtëm kushtetues për gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, për të gjithë, pa dallim. Komisioni i Venecias na ka thënë “jo” bazuar edhe në disa praktika të tjera. Seanca plenare e Venecias është formale, takimet veç e veç me raportuesit besoj që janë pjesa më e rëndësishme. Ata na kanë treguar se sa sfidë është që të futemi ngjashëm siç ka bërë Shqipëria, prandaj kanë propozuar një formë tjetër të vetingut. Dhe, në qoftë se në këtë Kuvend do të më kërkonit të gjithë si opozitë, kryetar...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Po, në rregull, po ti duke e shpjeguar sa i rëndësishëm është, shkuan dy minuta. Lirisht!

MINISTRJA ALBULENA HAXHIU: Nëse opozita do të kërkonte që pavarësisht çka ka thënë Venecia, ne duhet të shkojmë me vetingut të të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, më besoni që jam e bindur se kemi pas diskutim edhe me grupin parlamentar njësoj do të vepronte dhe grupi parlamentar.

Por, kur ka dalë Komisioni i Venecias me opinion, të gjithë njëzëri, përfshirë shoqërinë civile dhe partnerët kanë kërkuar që Qeveria ta mbështesë rekomandimin e Komisionit të Venecias. Dhe, po ashtu, tha që nuk e kemi besimin e partnerëve apo nuk e kemi pasur, për mua është e rëndësishme ta kemi besimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kjo është çështja kryesore, pra ne kemi pasur besimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës për ta bërë vetingun në sistemin e drejtësisë, prandaj kjo është për mua e rëndësishme, ndërsa me partnerët ndërkombëtarë, me shoqërinë civile, me pjesën tjetër të institucioneve mund të kemi në vazhdimësi diskutime për t'u përballur me argumente. Faleminderit, sepse koha mbaronte këtu dhe ma shtoi dhe një minutë, faleminderit kryetar. Prandaj, kjo ka qenë për mua e rëndësishme.

Partnerët ndërkombëtarë, e vërtetë, kanë thënë që Kosova nuk duhet të ketë veting, Kosova duhet vetëm t'i fuqizojë mekanizmat e brendshëm të vetingut dhe as Komisionit të Venecias dhe as partnerëve ndërkombëtarë nuk u flas ashtu siç theksove. Flasin raportet që i bëjnë vetë partnerët ndërkombëtarë, flasin raportet që i bëjnë vetë organizatat vendore të shoqërisë civile, me atë gjuhë i flasim ne, Venecias ne ia kemi dërguar raportin e organizatave ndërkombëtare, Departamentit Amerikan të Shtetit, raportit për vendin, organizatat e shoqëritë civile edhe mbi bazën e atyre janë evidentuar problemet me të cilat ballafaqohet sistemi i drejtësisë.

Ju po relativizoni rolin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, janë mekanizmat më të rëndësishëm brenda sistemit, shkarkojmë, emërojnë, dispijlojnë, merren me aspektin profesional, pra janë kyçë që...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Zonja Kica-Xhelili, urdhëroni!

DOARSA KICA-XHELILI: Dallimi esencial, ministre, mes meje e teje është që unë e kuptoj dallimin mes dëshirës dhe mundësisë. Dhe, ajo që për ty duket që mund të jetë dëshirë e imja, është në fakt ballafaqim i imi me realitetin, sepse unë ashtu e konceptoj reformën, demokracinë edhe shtetin. Jo si fontanë dëshirash të mia personale, por si mundësi, se si ti mund të ndërveprosh me atë që ty ta lejon vetë sistemi demokratik dhe duke e kuptuar këtë ndërveprim demokratik, në fakt, e thashë pikërisht atë që ta thashë.

Tani po e shoh që po e bën njëllor ndarje ndryshe kur po flet se si vetingu qenka hallka e parë e prioritizuar, atëherë unë mund ta shtoj një pyetje tjetër: po të ishte hallka e parë e prioritizuar, pse nuk ishte reforma e parë që iu prezantua Komisionit të Venecias? Pse nuk i thamë Komisionit të Venecias që do të konsiderojmë që të heqim dorë nga të tjerat nëse prioritizoni vetingun. Ju keni shkuar me reforma paralele pikërisht te Komisioni i Venecias dhe cila ishte reforma e parë që u dorëzua? Ishte ristrukturimi i Këshillit Prokurorial, sepse këtu e keni ju vëmendjen, te anëtarët e Këshillit Prokurorial, por jo t'i pavarësoni. Pavarësimi nuk nënkupton

që ju të bëni rotacione e t'i hiqni disa e t'i bini tre pastaj, t'i bini anëtarët në radhët e të cilëve mund të jenë figura të dyshuara që mund të kenë anime politike, pavarësisht nëse bëhen ose jo, se fundja duhet ta marrë votën e të gjithë deputetëve këtu.

Dhe, për fund, besimin e qytetarit për ta bërë vetingun the e kemi dhe nuk ka rëndësi nëse e kemi besimin e aktorëve ndërkombëtarë, atëherë e kam vetëm një çështje: dil e tregoj qytetarëve pse duke e zbatuar opinionin e Venecias që janë ndërkombëtarë nuk po e mban premtimin që ua dhe qytetarëve të tuaj për vetingun. Sepse, kjo që e kemi sot para vetes është larg asaj që është synuar të bëhej dhe unë absolutisht nuk po e them si gjë pozitive, as nuk mendoj që ti i je gëzuar aq më pak kësaj, unë jam e bindur që ti e ke dashur vetingun që është synuar në fillim, por nëse qenka vetëm qytetari rol këtu dhe paska rëndësi vetëm çka thotë ai, atëherë dil jep përgjegjësi pse s'po e bën? Sepse kjo nuk është. Dhe nëse vazhdojmë të mosballafaqohemi me realitetin e të themi gjëra të tilla, do t'i dështojmë edhe reformat e tjera, sepse kjo qasje nuk do të na dërgojë askund. Ne jemi këtu për të ndihmuar, andaj kur duam t'u ndihmojmë reformave, kur duam të ballafaqojmë edhe ty me realitetin, merre në fakt si ndihmë e jo si domosdoshmëri për reaksion që rëndom po e merr.

KRYETARI: Jo, nuk ka, kundër-replikë ishte kjo, replikën e patët ju, zonja Haxhiu, fjalimin e patët më herët, kështu që ia japim fjalën Besnik Tahirit.

BESNIK TAHIRI: Faleminderit, kryetar!

E nderuar ministre,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ajo që e prezantoi profesori Kujtim Shala, është një konsensus ndërpartiak, i cili është diskutuar në Komisionin ad hoc dhe i cili po e merr një epilog tash, pak a shumë një epilog, të cilin ne e kemi ditur, për shkak se ne e dimë që ndryshimet kushtetuese nuk mund t'i ndryshojmë pa e pasur edhe 2/3 e pakicave.

Pse jam para jush, të nderuar deputetë, në këtë fjalim që nuk e pata nijet ta bëja, po unë mendoj që duhet t'i them disa të vërteta, të cilat duhet t'i dinë edhe qytetari i Kosovës. Kur e kemi nisur këtë diskutim me shefat e grupeve parlamentare e me kryetarin e Kuvendit, e kam shtruar një pyetje: a po duam të bëjmë reformë dhe veting përmes ndryshimeve kushtetuese, apo përmes amandamentimit të ligjeve ekzistuese? Për shkak se, në qoftë se duam të bëjmë veting përmes ndryshimeve kushtetuese, epilogu i kësaj dihet, kjo nuk ndodh dhe dy-tri vjet mbrapa jemi në këtë situatë. Jemi në një situatë, kur në mars bëhen dy vjet, ku ministrja Drejtësisë e ka marrë përgjigjen e parë prej Komisionit të Venecias, i cili nuk ka qenë më i miri, dhe i cili pastaj do të thotë që u reflektua në Ministrinë e Drejtësisë në qershor. Pra, duhet të jemi të sigurtë se a duam të bëjmë politikë, apo të bëjmë reforma në drejtësi. Përmes ndryshimeve kushtetuese, apriori në atë kohë ne e kemi ditë që s'mundemi ta bëjmë dhe jemi në një situatë ku jemi.

E dyta, ne jemi duke folur shumë për Komisionin e Venecias, t'ju them të drejtën, është pak edhe nënçmuese për ne që jemi gati 20 vjet në këtë funksion që për gjithçka të gjejmë një adresë, "po e dërgojmë në Komision të Venecias". Kam qenë kundër edhe në Komisionin për Media kur kemi folur për KPA-në. Si shtet që duam të rritemi, që të mund të marrim përgjegjësi institucionale, të japin llogari për çka jemi këtu, fillimisht duhet të përgjigjemi dhe të themi se a duam të bëjmë një veprim me konsensus ndërpartiak, apo jo. Këtu janë dy taborë: e para, nisja e kësaj legjislature ka filluar me një arrogancë të madhe e të paparë, e cila ka buruar nga besimi që ka qenë besimi më i madh ndonjëherë që e ka marrë një subjekt politik dhe këtu kritika, fillimisht shkon për Kabinetin qeverisës, të cilët u verbuan të shohin jetën demokratike dhe politike në sistem parlamentar, ku zëri, shumica, konsensusi partiak për ta shtyrë një agjendë kombëtare është jetik. Pra, asnjë agjendë sikur tash që do të vijë marrëveshjet ndërkombëtare dhe as reforma e drejtësisë nuk mund të ndodhë fillimisht pa u pajtuar që edhe pakicat, sado që janë ata, e kanë rolin e vet.

E çka ka ndodhur, në vazhdimësi ka ndodhur një injorim dhe kemi devijuar mund të them këtu edhe në Komisionin për Legjislacion, kemi devijuar në trajtimin e një teme prej këndvështrimit të ndryshimeve kushtetuese, që apriori e kemi ditur se nuk do të ndodhë. Dhe këtë duhet ta themi hapur, pra kemi hyrë në një ushtrim për të ushtruar funksionet, dijen, elementet që ndërlidhen me profesionistë në temën e legjislacionit dhe temat kushtetuese, por jo me një synim për të bërë një ndryshim përmbajtësor.

Çështja tjetër që duhet të thuhet ta dijë qytetari i Kosovës është që i gjithë komunikimi politik në Kuvend, në raport me sistemin e drejtësisë ka qenë jashtëzakonisht i dëmshëm për demokracinë e Kosovës dhe për sundimin dhe ruajtjen e funksioneve që i kanë pushtetet e ndara në demokraci. Nuk jam këtu askujt t'i tregojë qysh ndahen pushtetet, mirëpo jam ta them një të vërtetë prej kësaj foltore, kryeministri ka bërë adresime serioze, eklatante kundër sistemit të drejtësisë. Pra, jemi duke folur për akuza shumë të rënda, e kemi zëvendëskryeministrin, ju lutem, të nderuar deputetë, që pa kurrfarë nevojë e trajton, e gjykon, e sulmon Gjykatën Kushtetuese si të ishte kooperativa e Kërpimehit, jo Gjykata Kushtetuese, ju lutem. Gjykatë Kushtetuese që ne po i votojmë njerëzit, që ne e votuam dje një kandidat që e mori shumicën që kishte qenë me notën më të lartë. Mos se nuk bën kështu, nuk ndihmojmë. Unë e kuptoj, shikoni unë e kuptoj aspektin politik se vetë kam qenë gjatë zëdhënës, e drejtor i Zyrës për informim në AAK, e lloj-lloj funksione, e kuptoj që jemi kah shkojmë kah trendi, kah trendi votues, e një pjesë e votues u pati lodhur shumë duke thënë UNMIK-u, ndërkombëtarët, e kishe po i mbështesim këta e po shkojmë kundër.

Janë disa shtylla të shtetit, të cilat ka një kontribut, ka një histori, ka një kontribut që vjen edhe nga subjekti juaj politik, ato duhet t'i ruajmë në veçanti këto të sistemit të drejtësisë. Unë e kam një propozim, ministre, propozimi im është që para se t'ua hedhim topin në Komisionin të Venecias, ambasadave e organeve të tjera, a ka mundësi që të ulemi seriozisht e ta trajtojmë ku të

doni, a doni në Kryesi, a doni në Komision për Legjislacion, ku jemi me Adnanin e Dritonin, edhe të shohim kah po e marrim rrugën, kah po shkojmë në drejtim të vetingut, çka po duam të bëjmë me bë këto ligje, a kemi pasur ne ta bëjmë atë Byronë veç sa t'u thuhet votuesve që ne po e bëjmë Byronë për shkak se po duam t'ua marrim hajrave pasurinë, a po duam përnjëmend të bëjmë një institucion që heton e shikon qysh e ka Besnik Tahiri pasurinë, edhe a e ka një lugë me hajni.

Në qoftë se duam ta bëjmë këtë, duhet të ulemi dhe të diskutojmë edhe sistemin e vetingut, edhe duhet diskutuar Byronë, edhe sistemin e drejtësisë në Këshillin Prokurorial të Kosovës, edhe atë të KGJK-së, por jo prej këndvështrimit prej flamurit partiak, se ne po duam ta bëjmë. Nuk ka vota këtu, këtu ka koncept politik të ruajmë një shtet, të cilin e kemi bërë me gjak, me vështirësi të mëdha, me sakrificën e të gjithëve, e edhe tuajën se keni qenë dhjetë vjet keni qenë nëpër protesta për të ardhur në këtë ditë të bëhesh ministre e Drejtësisë. Unë mendoj që ne duhet ulur e të themi fillimisht kemi gabuar që kemi thënë me ndryshimin kushtetues, se s'mund ta bëjmë. E dyta, qysh po e bëjmë? Jo ta kapim, por t'ia japim pavarësinë institucionit, ata që të vjetërit që kanë qenë në sistem të drejtësisë shkuan, besoni shkuan, domethënë kanë ardhur para pensionit dhe janë duke ardhur do gjenerata, do gjykatës e prokurore e prokurorë të rinj, të cilët e kanë guximin.

Ju kërkoj falje që e nisa me këtë qëndrim, por duke qenë se prej ditës së parë kam kërkuar qartësi, e kam lypur këtë qartësi prej Glauk Konjufcës, prej komisionit, prej diskutimit që e kam pasur me Adnanin, a po duam të shkojmë me ndryshime kushtetuese a me ndryshim të ligjit? Në qoftë se shkoni me ndryshime kushtetuese, ia pafshi hairin, nuk keni për të mundur të bëni asnjë gjë, se s'janë këta zotërinjtë këtu dhe s'e kanë në plan të vijnë, edhe e kanë në plan ta shtyjnë politikën armiqësore të Vuçiqit sa të munden. Pra, harrojeni këtë, të mos bëjmë debat koti, në qoftë se doni t'i ndryshoni ligjet, atëherë çka po ndryshojmë? Cila është analiza? Harroni këto vlerësimet që po na jep një organizatë ndërkombëtare a dikush, cili është vlerësimi i ministrisë, dy faqe. Në cilat pika mund të mbërrijmë diçka të përbashkët, në ato pika qysh mundemi t'i përmirësojmë edhe pse, cila është evidenca? Mbi këtë e ke mbështetjen, por jo të flasim këtu për ndryshime kushtetuese që apriori në ditën e parë e kemi ditur që s'bëhen. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën po ia japim Hajdar Beqes.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Qytetarë të nderuar,

Realisht sot po flasim në Kuvendin e Republikës së Kosovës për një çështje të rëndësisë së veçantë, për të cilën kanë diskutuar gjatë të gjitha subjektet politike, ndoshta kanë qenë edhe tema kryesore të fushatave për vetinge të thella në sistemin e drejtësisë, por ne kemi arritur falë angazhimit të gjithëve që të kemi një konsensus të vijnë deri këtu.

Ne si Komision për Legjislacion e kemi parë me vëmendjen aktgjykimin e Gjykatës Kushtetuese dhe në të njëjtën kohë i kemi dhënë rekomandimet tona, kemi qenë të kufizuar për shkak që realisht Gjykata Kushtetuese e ka pasur një aktgjykim të qartë dhe ne nuk kemi pasur kompetencë të dalim jashtë asaj. Për mendimin tim, edhe pse dëshiroj që përmes këtyre ndryshimeve të arrihet ajo reforma e pretenduar për një veting, unë konsideroj që në këto tri amendamente pjesërisht, realisht dy pjesërisht dhe njëra e përkrahur nga Gjykata Kushtetuese nuk arrihet qëllimi i vetingut.

Ne mund ta përdorim vetëm për poenë politike apo për diçka tjetër, por jo me të vërtetë për të bërë atë reformën e apostrofuar. Ne e kemi pas edhe një historik të vetingut, ne e dimë që Komisioni i Venecias e ka përkrahur Kosovën që të ketë veting dhe është evidente që sistemi i drejtësisë duhet të ketë veting në Republikën e Kosovës, megjithatë komisioni ka kritikuar mënyrën si planifikonte Qeveria të bëjë vetingun, duke përcaktuar se vetingu me ndryshime kushtetuese mund të ketë vetëm në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin Prokurorial dhe kryetarët e gjykatave. Ndërsa, pjesa tjetër të bëhet me reformë ligjore, duke përdorur mekanizma ekzistues.

Unë mendoj që këtu nuk u bë një analizë e mirë, edhe pse ka bërë një punë të mirë komisioni nga të gjitha subjektet politike, por pyetja ime është a arrihet qëllimi që të jetë vetëm në nivelin menaxherial, në këtë rast në Këshill Prokurorial, në Këshill Gjyqësor, edhe me kryetarët e gjykatave dhe prokurorive të bëhet një veting i tillë. Një formë apo tjetër, fillimisht nuk ka pasur transparencë dhe, edhe Komisioni i Venecias e diskualifikoi Qeverinë që ta bëjë vetingun dhe këtë me kërkesë të Partisë Demokratike këtë proces e sollëm në Kuvendin e Republikës së Kosovës, pasi ishin edhe ato takimet e lidërshit dhe mendoj që një formë apo tjetër u bë një pretendim për të punuar në këtë drejtim. Por, nëse e marrim qëllimin çka kemi dashur të arrijmë me këtë, unë mendoj që nuk kemi arritur aty ku duam.

Sidoqoftë, amendamentet e propozuara nuk përfshijnë tri aspektet e lartcekura për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët e sistemit të drejtësisë. Nga ana tjetër, edhe pse procesi në Kuvend është zhvilluar më shpejt se sa kishte nevojë, ky proces kaq i rëndësishëm me gjithë amendamentet u hartuan dhe u propozuan me konsensus të plotë të gjitha partive politike. Ndërkaq, së fundi saktësisht para diku 3 jave Gjykata Kushtetuese shpalli aktgjykimin e plotë me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së amendamenteve të propozuara kushtetuese dhe konstatoi se nga 3 këto amendamente dy prej tyre duhet të ndryshohen pjesërisht.

Amendamentet e propozuara kushtetuese ndërlidhen me zgjerim-plotësimin e bazave të përhershme kushtetuese për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Kosovës, amendamenti 27 dhe 28, që janë të karakterit të përhershëm, si dhe dy, procesi kalimtar të përkohshëm të kontrollit të integritetit të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, kryetarëve të gjitha gjykatave, kryeprokurorëve të shtetit dhe të gjithë

prokurorëve, si dhe kandidatëve për këto pozita, përkatësisht, procesin e vetingut në sistemin e drejtësisë që është i karakterit të përkohshëm.

Edhe një herë, kryetar, mendoj që ne edhe ashtu nuk kemi mundësi sot, ne do t'i përkrahim për shkak që kemi pasur anëtarët tonë në komision, por unë personalisht jam skeptik që me këto tri amendamente, edhe ashtu tash të ndryshuara nga Gjykata Kushtetuese, mund të arrijmë këtë qëllim. Jam shumë optimist dhe i bindur që vetingu kishte mundur të ndodhë pa e ndryshuar Kushtetutën, më mirë se sa me këto ndryshime që po dëshirojmë t'i bëjmë, e të cilat i kemi të pamundur t'i bëjmë. Unë edhe një herë kërkoj që të mos e përdorim vetingun për poenë politike dhe të mos e matim me teori çka kemi bërë reformë në drejtësi, sepse nuk po shihet ndonjë zhvillim i madh në drejtësi, përkundrazi kemi ndërhyrje direkte nga pushteti ekzekutiv në pushtetin e gjyqësorit, të mos them ndonjëherë edhe individë nga legjislativi. Faleminderit!

KRYETARI: Këto ishin diskutimet, tash ju ftoj që të ktheheni në sallë të gjithë deputetëve. Së pari mendoj që duhet të jemi 80, ashtu që të plotësohet kriteri elementar për votimin e ndryshimeve kushtetuese.

Po e lexojmë edhe një herë nenin 144 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Çdo ndryshim do ta kërkojë miratimin e 2/3 të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë këtu 2/3 e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vende të rezervuara ose të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës”. Ky është neni, kështu që fillimisht e lus Administratën të na tregojë kur jemi 80, në momentin që jemi 80, pastaj e shohim se a janë 14 deputetë të pranishëm të komuniteteve joshumicë. Uluni!

Më tregojnë që 84 deputetë qenkemi të pranishëm në sallë, 86 u bëmë tash, 87. Por, nga komunitetet e tjera joshumicë janë të pranishëm 8 deputetë, duhet të jenë 14 ashtu që të ketë shans që këto ndryshime dhe votime të amendamenteve të ndodhin.

Kështu që ne mund të konstatojmë që në Kuvend nuk ekzistojnë kushtet për procedurën e votimit të amendamenteve kushtetuese.

(Ndërhyrje)

Jo, jo, mëditje nuk marrin ata që s'janë, është e nënkuptueshme, por diçka më shumë se... Mirë! S'ka mundësi të bëhet kjo. Mbetet kur të krijohen kushtet.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*